



BACHELOR
THEOLOGJI SOCIALE
DHE SHKENCA
RELIGJOZE



MASTER SHKENCOR
TURIZËM
RELIGJIOZ



MASTER PROFESIONAL
THEOLOGJI SOCIALE
DHE PRAKTIKE

BULETIN INFORMATIV



Të Diplomuarit e Rinj të Programit Bachelor & Master

Në datat 14 dhe 15 qershor 2023 u zhvilluan provimet e diplomimit dhe mbrojtja e tezave të programit Bachelor dhe Master Shkencor të Departamentit tonë në Skitin e Grave Miroprurëse. Përfundoi studimet gjenerata e tretë e të diplomuarve në programin Bachelor në Theologji Sociale dhe Shkencën Religjioze në Kolegjin Universitar “Logos”. Në një ceremoni të shkurtër përmbyllëse, studentëve iu dha diçka simbolike si kujtim për përfundimin e studimeve të tyre.

Media sociale



Tel. +35569 30 30 277

Gjithashtu, studentët e Masterit Shkencor në Turizëm Religjioz janë të diplomuarit e parë të këtij programi ekskluziv në Arsimin e Lartë të Shqipërisë. Dëshirojmë t'i përgëzojmë ata për këtë arritje, pasi, nga sot, ata konsiderohen specialistë në një sektor të veçantë të turizmit. Së fundi, dëshirojmë të falënderojmë Skitin e Grave Miroprurëse për mikpritjen e ofruar në realizimin e këtij eventi të veçantë. Duke klikuar foton më poshtë, mund të shikoni një video me intervista pas mbrojtjes së tezave.



Shkollat Verore për Studentë të Shkollës së Mesme dhe të Universitetit

Shkolla e dytë verore për studentët e shkollave të mesme u zhvillua në Manastirin e Shenjtë të Shën Vlashit nga data 10 deri më 13 korrik. Studentët morën pjesë në shumë aktivitete me kurse, ekskursione në qytetin e Durrësit dhe Manastirin e Ardenicës dhe e përmbyllën praninë e tyre me aktivitetin “Gjetia e Thesarit”. Në fund të ditës, studentët morën certifikatën e pjesëmarrjes.



Gjithashtu, në ambientet e Kolegjit Universitar “Logos” u zhvillua, nga data 17 deri më 22 korrik, shkolla e parë verore për studentët e universitetit në Studime Religjioze dhe Turizëm Religjioz me kontributin e Elite Travel Group, i cili organizoi një trajnim dyditor për studentët tanë si guida turistike. Shkolla verore përmbante kurse mbi Studimet Religjioze, Theologjinë, Turizmin Religjioz dhe Arkeologjinë e Krishterë si dhe ekskursione në muze dhe vende arkeologjike në Durrës dhe Berat. Në fund të shkollës verore, studentët morën një certifikatë që vlerësohej me 3 ECTS ngarkesë pune.

Klikoni në ikonën më poshtë për të mësuar më shumë rreth aplikimeve në Universitet.

Kalendari i Aplikimit Universitar 2023

Raundi I			Raundi II		
10 → 27	29 → 3	27	29 → 14	15 → 17	21
PROJEKTI E TËRISHA	PROJEKTI E TËRISHA	PROJEKTI E TËRISHA	PROJEKTI E TËRISHA	PROJEKTI E TËRISHA	PROJEKTI E TËRISHA
28	29 → 11	12 → 13	22 → 1	2 → 3	4 → 10
PROJEKTI E TËRISHA	PROJEKTI E TËRISHA	PROJEKTI E TËRISHA	PROJEKTI E TËRISHA	PROJEKTI E TËRISHA	PROJEKTI E TËRISHA

www.kulogos.edu.al

Liturgjika 1: Hyrje në adhurimin hyjnor

(*klikoni në kopertinën më poshtë për të mësuar më shumë mbi botimin e librit të 11-të të Departamentit)

